VENDIM
Nr. 118, datë 14.10.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENERGJIA D.O.O VETERNIK" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 germa "d" dhe 110 të ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", neneve 4, pika 1, germa "g"; 5, pika 2; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a" e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Energjia D.O.O Veternik" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Energjia D.O.O Veternik" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germat "a", "b" dhe "c"), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), (statuti ligjor i shoqërisë), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin shoqërisë "Energjia D.O.O Veternik" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti